



FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

Prishtinë 21 maj 2022

RREGULLORE E GARAVE NË SUPERLIGËN E KOSOVËS 2022

Neni 1

Në kuadër të kalendarit të vet të garave , FSHK organizon garat në Superligën e Kosovës duke filluar nga data **21 - 26/05/2021** në **Capital Gate** – Prishtinë në zonën industrial përballë ETC sipas këtij orari:

Shtune	21/05	Ora	14.30	Hapja Solemne
	21/05	Ora	15.00	Xhiroja e I
Diele	22/05	Ora	09.00	Xhiroja e II
Diele	22/05	Ora	16.00	Xhiroja e III
Hëne	23/05	Ora	15.00	Xhiroja e IV
Marte	24/05	Ora	15.00	Xhiroja e V
Mërkure	25/05	Ora	15.00	Xhiroja e VI
Enjte	26/05	Ora	15.00	Xhiroja e VII

Neni 2

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë këto ekipe: **Dardania, Drejtësia, Drenica, Hyzri Talla, Istogu, Prishtina dhe Prizreni.**

Neni 3

Kotizimi për pjesëmarrje dhe anëtarësia vjetore në vlerë prej **200€** duhet të paguhet para fillimit të kampionatit.

Neni 4

Sipas rregullores së afatit kalimtar çdo klub ka të drejtë ta aktivizojë nga 1 shahist të huaj në ndeshje.

Neni 5

Garat zhvillohen sipas Sistemit të Bergerit (rrethor, secili me secilin), në një vend në kohën e zhvillimit të garave ashtu siç është përcaktuar në nenin 1.

Neni 6

Shorti është i tipit të dirigjuar duke u bazuar në mesataren e 6 shahistëve me ELO më të mirë **(vetëm një i huaj ndërsa nuk llogariten shahistët pasivë)** me formacionin bazë të rradhitur sipas rejtingut por diferenca e rejtingut mos te jetë më e lartë se 100 pikë nga tabela paraprake. (psh tabela e dytë mundet me qenë 2400 por e para nuk mundet me qenë më e vogël se 2300).

Neni 7

Referë të ndeshjes janë : **1. Burhanudin Misini, 2. Fatmir Gërguri dhe 3. Albert Zenuni.**

Neni 8

Në komisionin e garave prej 3 anëtarëve do të jenë : **Armend Budima, Bedri Sadiku dhe Afrim Fejzullahu** ndërsa rezervë **Valmor Bardhi dhe Abedin Idrizaj.**

Neni 9

Formacioni do të jetë bazë **(neni 6).**

Neni 10

Garat zhvillohen në **gjashtë (6) tabela.**

Neni 11

Kapitenet e ekipeve formacionet do t'i japin online. Të bashkangjitur e keni ankesin **A** me udhëzime.

Neni 12

Tempo e lojës është **dyzet (40) lëvizje për 90 min dhe 15 min.** për përfundimin e lojës me **30 sekonda bonus** për çdo lëvizje duke filluar nga e para. Gjatë lojës vlejnjë Rregullat e FIDE për lojë standarde.

Neni 13

Koha e pritjes së kundërshtarit është **30 minuta** nga koha e paraparë për fillimin e ndeshjes.

Neni 14

Plasmani i ekipeve përcaktohet në bazë të pikëve të fituara, meç-pikët sipas sistemit: për **fitore 2 pikë, barazimi 1 dhe humbja 0 pikë.** Në rast se **2 ekipe** kanë pikë të njejta ekipore zbatohen këto rregulla:

- a) Ndeshja direkte
- b) Shuma e pikëve tabelare
- c) Dy ndeshje shtesë në rapid (2x15min+5sec.) me formacionet e pandryshuara nga xhiroja e fundit.
- d) Dy ndeshje shtesë në blic (2x5min+2 sec) me formacionet e pandryshuara.
- e) Nga dy ndeshje shtesë blic (2x5min+2 sec) me formacionet e pandryshuara gjer në përcaktimin e fituesit.
- f) Nën pikat **(c, d, e)** në rast barazimi vendosin pikët tabelare.
- g) Nëse kemi **3** apo më shumë ekipe me pikë të njejta, pika **(a)** nuk zbatohet, dmth vendos pika **(b)** e me rradhë.

Neni 15

Ekipi që zë vendin e parë shpallet kampion i Kosovës për vitin 2021. Ky ekip përfaqëson Kosovën në garat e Kupës Evropiane ECC 2022 në Austri. Ekipi që rradhitet në **vendin e shtatë** largohet nga Superliga dhe vitin 2023 garon në ligën e dytë.

Neni 16

Shpërblime do të ketë për 3 vendet e para :

- 1) Vendi I - 500€, kupë dhe diplomë.**
- 2) Vendi II - 400€, kupë dhe diplomë.**
- 3) Vendi III - 300€, kupë dhe diplomë.**

Neni 17

Ndeshjet nuk mund të shtyhen.

Neni 18

Nëse një ekip largohet nga gara apo përjashtohet nga gara dhe ka luajtur :

- a)** më pak se gjysmën e ndeshjeve, rezultatet e tij fshihen në vazhdimin e garave dhe rezultatet e arritura anulohen.
- b)** gjysmën apo më shumë ndeshje, atëherë ajo i humb të gjitha ndeshjet e mbetura duke e llogaritur edhe ndeshjen e humbur me kontumacion me 0 pikë ekipore dhe pikë tabelare, ndërsa kundërshtarët marrin nga 2 pikë dhe pikët tabelare të njëjtë si humbja e tyre më e lartë gjatë ndeshjeve. Nëse ajo ekipë gjer në atë xhiro nuk ka humbur asnjë ndeshje atëherë kundërshtarët marrin nga 2 pikë ekipore dhe 3.5 pikë tabelare.
- c)** Nëse ekipi humb një ndeshje me kontumacion, ajo mund ta vazhdojë garën por nëse ky rast përsëritet edhe njëherë gjatë garës ndëshkohet me përjashtimin e saj nga gara dhe kalimin e saj në një rang më të ulët të garave me mundësi që edhe në këtë rang të startoj me minus pikë apo me marrjen e pikëve të cilën e vendos Federata e Shahut.

Neni 19

Që ekipi të ketë mundësi të fillojë ndeshjen, duhet të ketë numër të mjaftueshëm të lojtarëve që nënkupton më së paku **4 lojtarë (50%+1)**

Neni 20

Çdo ekipë duhet ta ketë kapitenin e tij i cili mund të jetë edhe nga rradhët e lojtarëve. Në listën e formacionit të ekipit shënohet emri i tij.

Neni 21

Detyrat e kapitenit janë :

- a)** ta dorëzojë formacionin e ekipit të tij tek referi i garës.
- b)** t'i informojë anëtarët e ekipit të tij për propozicionet, rregullat e garës dhe vendimet e referit dhe komisionit të garave. Të gjitha informatat e dhëna kapitenit konsiderohen si të dhëna tërë ekipit.
- c)** ta përfaqësojë ekipin e tij në garë.
- d)** që në emër të ekipit të tij të bëjë propozime ose ankesa tek referi apo komisioni i garave.
- e)** të përkujdeset për disiplinën e anëtarëve të tij.

Neni 22

Gjatë ndeshjes kapiteni mund t'i drejtohet anëtarëve të ekipit të tij vetëm në çështjet që nuk kanë të bëjnë me zhvillimin aktual të ndeshjes, vetëm atëherë kur në lëvizje është lojtari kundërshtarë dhe në prezencë të referit.

Neni 23

Gjatë ndeshjes lojtari mund t'i drejtohet kapitenit të tij në çështjet që kanë të bëjnë me ndeshjen si psh për konsultim në rastin e ofrimit të remit nga ana e kundërshtarit apo dëshirës që ai ti ofroj remi atij, dhe atë në prezencë të referit dhe kur nuk është në lëvizje, ndërsa kapiteni duhet t'i përgjigjet shkurt me **po** ose **jo** pa asnjë komentim dhe sqarim të pozitës në tabelë.

Neni 24

Nëse në ekip nuk janë prezent të gjithë lojtarët por është numri i mjaftueshëm i tyre, kapiteni i ekipit mund ta dorëzojë formacionin në dy mënyra :

- a) e plotëson formacionin me lojtarë që nuk janë prezent,
- b) i len rubrikat e zbrazëta në tabelat përkatëse të cilat dorëzohen pa lojë.

Në rastin a) nëse shahistët të cilët nuk janë prezent por janë të futur në formacion nuk vijnë me kalimin e 30 minutshit duke e llogaritur nga koha e caktuar për fillimin e ndeshjes, e humbin atë me kontumacion.

Neni 25

Lojtarëve nuk u lejohe largimi i hapsirës së ndeshjes pa miratimin e referit. Pa lejen e referit lojtari nuk guxon të ketë me veti telefon celular apo ndonjë mjet tjetër elektro komunikues, përveç nëse janë plotësisht të fikur. Nëse çfarëdo lloj mjeti prodhon apo lëshon ndonjë tingull, lojtari e humb lojën. Poashtu gjatë ndeshjes lojtarëve nuk u është e lejuar që të shërbehen me çfarëdo lloj shenimesh, burime informative ose këshilla, si dhe të analizojnë në tabelë tjetër të shahut apo të konsultohen me shokë e me kolegë të klubit për pozitën e arritur në tabelë.

Neni 26

Pirja e duhanit është e lejuar vetëm në atë pjesë të hapsirës të cilën e përcakton referi. Në këtë pjesë nuk është e lejuar që të gjinden njëkohësisht dy shahistë të të njejtit klub.

Neni 27

Në sallën e lojës u është lejuar prezenca vetëm lojtarëve dhe kapitenit të ekipit. Lojtarët rezervë dhe personat tjerë mund të hyjnë vetëm me miratimin e referit të ndeshjes apo referit të turneut. Por nëse situata e kërkon që shkak i mbarëvajtjes së garave, mbajtjes së rendit dhe disiplinës së duhur, largimit të dyshimeve të konsultimeve apo diqka të ngjajshme, referi mund të sjell vendim që lojtarët të cilët e kryejnë ndeshjen të largohen nga salla e lojës si dhe kapitenët ekipet e të cilëve e kanë përfunduar ndeshjen.

Neni 28

Kundër lojtarëve të padisciplinuar, kapitenit apo ekipit referi mund të shqiptojë ndëshkimet si në vijim :

- a) tërheqjen e vërejtjes,
- b) humbjen e ndeshjes
- c) largimin nga gara të kapitenit, lojtarit apo ekipit.

Neni 29

Lojtari i cili kapet duke përdorur program apo softver të shahut gjatë ndeshjes do të sanksionohet me diskualifikim nga garat dhe humbjen e pikës në atë ndeshje. Përpos këtyre ndëshkimeve do të dënohet me 2 vjet moslojë në garat e organizuara nga FSHK.

Neni 30

Në sallën e garave është e ndaluar ngrënia e ushqimit dhe përtypja e çamqakëzave.

Neni 31

Telefonat dhe orët e mençura do të dorëzohen tek referi para fillimit të ndeshjeve. Ato mund të mirren nëse lojtari i cili e ka kryer lojën dëshiron të shkojë në shtëpi dhe pas përfundimit të meçit nga ana e kapitenit. Secili ekip do ta ketë kutinë e posaqme.

Neni 32

Në vendimin e referit të ndeshjes kapiteni mund të ankohet tek komisioni i garave mbrenda **2 orëve** nga përfundimi i ndeshjes apo situatës kontestuese dhe e ka obligim që këtë ta paraqes në procesverbalin e ndeshjes.

Klubi i cili ushtron ankesë deponon në llogari të FSHK-së **20 €** në formë të kaucionit. Nëse ankesa shqyrtohet pozitivisht të hollat kthehen , në të kundërtën të hollat mbesin në llogari të FSHK-së. Ankesa duhet të shqyrtohet para fillimit të xhiros së ardhshme.

Vendimi i Komisionit të garave është përfundimtar.

Aneksi A

Manuali për kapitenët e ekipit

Formacioni bazë duhet të dërgohet në e mail adresën e referit kryesor burhanudin.misini@shahurks.com, gjer me datën 19.05.2022.

Formacionet e xhirove do të dërgohen në mënyrë elektronike si në vijim :

1. Hape <https://chess-results.com/TeamComposition.aspx>
2. Klikoje Superliga e Kosovës 2022.
3. Klikoje ekipin.
4. Shenoje fjalekalimin te rubrika LOGIN.
5. Shenoje e-mail adresen nese rubrika eshte e zbrazet.
6. Klikoje shahistet te cilet do te luajne ne kete xhiro.
7. Klikoje CONFIRM. Pas kesaj iu vjen konfirmimi ne e-mail.

Sqarim : Ju mund ta ndërroni formacionin sa herë të doni mbrenda intervalit kohor të shënuar në tabelë.

Nëse nuk jipet formacioni mbrenda afatit, në ndeshje do të hyhet me formacion bazë dmth sipas rradhitjes 1,2,3,4,5,6.

Xhiro	Fillimi	Mbarimi
1	21.05.2022 - 12:00	21.05.2022 - 14:00
2	22.05.2022 - 22:00	22.05.2022 - 08:00
3	22.05.2022 - 12:00	22.05.2022 - 14:00

4	23.05.2022 - 12:00	23.05.2022 - 14:00
5	24.05.2022 - 12:00	24.05.2022 - 14:00
6	25.05.2022 - 12:00	25.05.2022 - 14:00
7	26.05.2022 - 12:00	26.05.2022 - 14:00

Ndonjëherë egziston mundësia që të mos keni çasje në internet. Në këso rastesh mund ta kontaktoni referin kryesor 046 12 07 90 dhe nëpërmjet telefonit t ia jepni formacioni, por vetëm mbrenda afateve të caktuara në tabelën e mësipërme.

Interpretimi dhe finalizimi përfundimtar i kësaj rregulloreje është e drejtë ekskluzive e FSHK-së.